

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6684
E shtunë, 20 gusht 2022
çmimi 0.40 €

Kurti: Spanja duhet dhe do ta njohë Kosovën



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) INKURAJOJNË KOSOVËN DHE SERBINË PËR VAZHDIMIN E DIALOGUT

SHBA-ja, KOSOVËS DHE SERBISË:

VAZHDOJINI NEGOCIATAT!



Takimi në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të enjten në Bruksel ka përfunduar pa ndonjë marrëveshje. Pavarësisht kësaj, ShBA-ja u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i vazhdojnë negociatat për arritjen e

marrëveshjes përfundimtare. Zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) i ka inkurajuar Kurtin dhe Vuçiqin ta shfrytëzojnë dialogun në mënyrë efektive. Ai ka thënë se sekretari Blinken është i angazhuar personalisht në këtë proces

AMBASADORJA IZRAELITE: PO PUNOJMË PËR VIZAT PËR KOSOVARËT QË DUAN TA VIZITOJNË IZRAELIN



HARADINAJ, BE-së: ËSHTË KOHA TA DORËZONI DIALOGUN TE BIDENI

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



DAJA PAS FITORES NDAJ SHKUPIT: JA ÇFARË PRES NË NDESHJEN E DYTË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Putini dhe Xi do të marrin pjesë në samitin e G20-s

XHAKARTA, 19 GUSHT - Presidenti rus, Vladimir Putin, dhe ai kinez, Xi Jinping, do të marrin pjesë në samitin e radhës të G20-s, ka thënë lideri i Indonezisë, shteti i të cilit që do të jetë nikoqir i samitit. Nëse Putini dhe Xi do të merrnin pjesë në samitin e G20-s, atëherë do të hapej mundësia për bisedime me presidentin amerikan, Joe Biden, në kohën kur Uashingtoni ka përqësuar raportet me Kinën dhe Rusinë, veçanërisht për shkak të krizave në Ukrainë dhe Tajvan. Samiti i radhës i G20-s do të mbahet në Bali të Indonezisë në nëntor. Moska është izoluar pas nisjes së pushtimit të Ukrainës në

fund të shkurtit, ndërkaq lideri kinez ka kufizuar udhëtimet jashtë vendit për shkak të pandemisë së koronavirusit. Por, presidenti i Indonezisë, Joko Widodo, gjatë një interviste për "Bloomberg", ka thënë se dy liderët do të marrin pjesë fizikisht në samitin e G20-s. "Xi Jinping do të vijë. Presidenti Putin po ashtu më ka thënë se do të vijë", ka thënë Widodo. Zyrtarët e Kremlinit kishin thënë në qershor se Putini ka pranuar ftesën e Widodos për të marrë pjesë në samit, dhe do të shkojë në Indonezi nëse kushtet lidhur me pandeminë e lejojnë atë. Indonezia aktualisht udhëheq me

presidencën e G20-s. Xhakarta u vu nën presionin e Perëndimit për të mos e ftuar Putinin në takimin e G20-s, pasi Indonezia njoftoi në prill se e kishte ftuar liderin rus. Por, Indonezia ka mbajtur një pozicion neutral duke bërë thirrje për zgjidhje paqësore për luftën në Ukrainë dhe Widodo më herët gjatë këtij viti ka vizituar edhe Kievin, edhe Moskën. Edhe Ministria e Jashtme e Indonezisë ka thënë se liderët e Rusisë dhe Kinës kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në samit. Indonezia po ashtu ka ftuar në samit edhe presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky, në përpjekje për të gjetur një kompromis midis



Moskës dhe Kievit. Zelensky, shteti i të cilit nuk bën pjesë në grupin e 20 ekonomive

më të mëdha në botë, ka thënë se ai do të marrë pjesë në samit, të paktën përmes video-lidhjes.

Britania përballet me "krizë humanitare", rriten çmimet e energjisë

LONDËR, 19 GUSHT - Britania do të përballet me "krizë humanitare" gjatë këtij dimri, kur familjet me të ardhura të ulëta do të përballen me fatura të shtrenjta të energjisë dhe kjo mund të shkaktojë probleme serioze fizike dhe mendore, tha një grup lobues për kujdesin shëndetësor.

Kryeministri britanik, Boris Johnson, u ka rezistuar thirrjeve që të ofrojë më shumë mbështetje për amvisëritë që përballen me fatura të shtrenjta të energjisë. Ai ka insistuar se qeveria do t'ia lë këto vendime të mëdha fiskale kryeministrit të ri që do të marrë mandatin në shtator. "Shteti po përballet me krizë



humanitare", ka thënë Matthew Taylor, shef i Konfederatës së Shërbimit Kombëtar të Shëndetësisë. Kjo konfederatë

përfaqëson të gjithë organizatat e kujdesit shëndetësor në vend. "Shumë njerëz do të përballen me zgjedhje të vështira dhe do të

detyrohen të zgjedhin që të heqin dorë nga një vakt ushqimor për të ngrohur shtëpitë e tyre dhe do të përballen me të ftohtin dhe me kushte të pakëndshme", tha ai përmes një deklarate.

Situata mund të shkaktojë edhe shpërthime të sëmundjeve të frymëmarrjes, të shëndetit mendor dhe të përkeqësimit të jetës dhe fëmijëve, por edhe mund të rrisë presionin ndaj sistemit veçse të ngarkuar shëndetësor, ka thënë Taylor.

Ndërsa zëdhënësi i Departamentit të Shëndetësisë në Britani, ka thënë se qeveria në maj ka ndihmuar amvisëritë me 44 miliardë dollarë, që janë pjesë e një

pakoje të ndihmës për jetesën, por edhe për të rritur kapacitetet e sistemit shëndetësor.

Faturat mesatare të energjisë për amvisëritë në Britani - që përfshijnë edhe faturat për gaz dhe elektricitet - mund të rriten për 4 000 funte, teksa inflacioni në korrik u rrit në mbi 10 për qind.

Pasi po përballet me presion të madh, qeveria e Johnsonit ka thënë javën e kaluar se është duke punuar në një pako të ndihmës për amvisëritë, të cilën kryeministri i ri që do ta shqyrtojë, por partia opozitare laburiste po kërkon që Parlamenti të ngrijë shtrenjtimin e faturave të energjisë.

'Twitter'-i ua pezullon llogaritë 12 anëtarëve të partisë së Vuçiqit

BEOGRAD, 19 GUSHT - Kompania "Twitter" ka pezulluar llogaritë e disa deputetëve dhe politikanëve të Partisë Përparimtare Serbe, e cila është në pushtet në Serbi, dhe të një zyrtari qeveritar.

Në mesin e personave që u është pezulluar llogaria në rrjetin social "Twitter" është edhe Arno Gujon, drejtor i Drejtorisë për Bashkëpunim me Diasporën dhe Serbët në Rajon, i cili është emëruar në këtë pozitë më 2020 nga Qeveria e Serbisë, raporton "REL".

"Twitter"-i sapo pezulloi llogarinë time ku kisha 34 000 ndjekës, pa

dhënë asnjë shpjegim", ka thënë Gujon përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe pse Gujon është i njohur për publikun në Serbi si një humanist që ndihmon serbët në Kosovë, aktiviteti i tij politik është i lidhur me lëvizjen identitare të ekstremist të djathtë.

"Twitter"-i pezulloi llogaritë e 12 anëtarëve të Partisë Përparimtare Serbe (SNS), të presidentit aktual, Aleksandër Vuçiq.

Në mesin e llogarive të pezulluara është edhe llogaria e organizatës joqeveritare CRTA që monitoron punën e Kuvendit. Në mesin e

personave që u janë pezulluar llogaritë në "Twitter" janë: Nevena Gjuriq, Sandra Bozhiq, Milica Nikoliq, Jelena Obradoviq, Aleksandar Markoviq, Kërsta Janjusheviq, Dushan Radojeviq, Jelena Zhariq-Kovačević, Aleksandra Tomiq, Stasha Stojanoviq, Zoran Tomiq dhe Andrijana Vasiq.

Kompania "Twitter", po ashtu, ka pezulluar llogaritë e disa anëtarëve të lartë të SNS-së, përfshirë edhe kryetarit të qytetit të Beogradit, Miroslav Čučkoviq, si dhe Slavisha Mićanoviqit, që sipas mediave udhëheq ekipin për media të SNS-



së. Kompania "Twitter" nuk ka komentuar menjëherë lidhur me pezullimin e llogarive të zyrtarëve serbë. Siç është thënë në faqen zyrtare, "Twitter" ka të drejtë të pezullojë

llogari nëse këto llogari shkelin rregullat e kompanisë.

"Shumica e llogarive që ne pezullojmë, pezullohen sepse ato janë të reme ose paraqesin reziqe të sigurisë për 'Twitter'-in apo për këdo që përdor 'Twitter'-in", është thënë në faqen e kësaj kompanie.

Në uebfaqen e "Twitter"-it, po ashtu, është thënë se llogaritë mund të pezullohen nëse të njëjtat dyshohet se janë hakuar. Pezullimi në raste të tilla zgjat derisa llogaria t'i kthehet pronarit. Kompania, po ashtu, mund të pezullojë llogari nëse janë në kundërshtim me politikat e kompanisë.

Administrata e Bidenit po përgatit 800 milionë dollarë ndihmë ushtarake për Ukrainën

Uashington, 19 gusht - Administrata e presidentit Joe Biden është duke përgatitur rreth 800 milionë dollarë ndihmë ushtarake shtesë për Ukrainën dhe mund ta shpallë atë të premtën, kanë thënë për "Reuters" tri burime të njohura për këtë çështje.

Bideni do ta autorizojë ndihmën duke përdorur autoritetin e tij presidencial të tërheqjes, i cili i lejon presidentit ta autorizojë transferimin e armëve të tepërta nga stoqet e ShBA-së. Burimet, duke folur në kushte anonimiteti, thanë se një

njoftim mund të bëhet javën e ardhshme, duke paralajmëruar se paketat e armëve mund të ndryshojnë në vlerë përpara se të shpallen. Deri tani Uashingtoni ka dërguar miliarda dollarë ndihmë për sigurinë për qeverinë e Kievit.



Ambasadorja izraelite: Po punojmë për vizat për kosovarët që duan ta vizitojnë Izraelin



PRISHTINË, 19 GUSHT - Izraeli e përkrah dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por nuk sheh ndonjë rol më aktiv të saj në këtë drejtim, ka thënë, në një intervistë për "Radio Kosovën", ambasadorja e Izraelit në Kosovë, Tamar Ziv. Ajo ka thënë se pret që bashkëpunimi ekonomik ndërmjet dy vendeve të përforcohet në të ardhmen. Më tutje, ajo ka bërë me dije se janë duke punuar për vizat për të gjithë qytetarët që dëshirojnë ta vizitojnë Izraelin.

Izraeli është shteti i fundit që e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Gjatë vitit të kaluar Kosova dhe Izraeli kanë vendosur marrëdhënie diplomatike. Në çfarë drejtimi mendoni se po zhvillohen raportet ndërmjet dy vendeve?

Tamar Ziv: Kosova dhe Izraeli kanë vendosur marrëdhënie diplomatike që nga shkurti i viti 2021 dhe për këtë, Izraeli ndihet mirë dhe është angazhuar për

thelimin e këtyre marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Kosova ka hapur ambasadën në Jerusalem, një muaj më vonë, dhe në ishim shumë të kënaqur dhe mirënjohës për këtë. Unë kam filluar punën time si ambasadore e Izraelit në Kosovë në prill të këtij viti. Që nga vendosja e raporteve diplomatike ndërmjet dy vendeve dhe më shumë që nga nominimi im në pozitën e ambasadores, ne kemi filluar të punojmë në vendosjen e raporteve në disa drejtime. Mendoj, që një nga drejtimet më të rëndësishme është themelimi dhe përforcimi i marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare ndërmjet vendeve tona. Mendoj që ka shumë fusha në të cilat mund t'i zhvillojmë këto raporte. Jam shumë e kënaqur me hapjen e Korporatës për Zhvillim dhe Investime Kosovë - Izrael. Kjo Odë është duke punuar me

Odën Ekonomike të Kosovës, por edhe Odat e tjera, në mënyrë që të organizojë një takim e që shpresojmë në nëntor, të bizneseve kosovare në Izrael dhe pastaj mendojmë edhe për një vizitë të delegacionit izraelit në Kosovë, në fillim të vitit 2023.

A mendoni që Izraeli duhet të ketë një rol më aktiv në zgjidhjen e problemit politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?

Tamar Ziv: Mendoj që Izraeli e përkrahë arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shpresojmë që dy vendet të arrijnë një marrëveshje sa më parë. Por jam e bindur që ju jeni duke u ndihmuar mjaftueshëm nga partnerë të rëndësishëm siç është Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Prandaj nuk mendoj që Izraeli ka çfarë të shtojë në këtë çështje, pas të cilës qëndrojnë shtete të fuqishme.

Kosova është një ndër shtetet e pakta që ka hapur ambasadën e saj në Jerusalem. Madje për këtë ka marrë kritika të ashpra nga Bashkimi Evropian dhe Turqia. A mund të pritet që edhe Izraeli të hapë ambasadën e saj ose, të paktën, konsullatë në Kosovë?

Tamar Ziv: Po, natyrisht! Por ky është një proces. Mendoj që duhet të fillojmë të punojmë në vendosjen e raporteve, duke e ngritur përmbajtjen dhe duke i rritur marrëdhëniet ekonomike. Dhe mendoj që kjo do të vijë më pas. Për sa i përket çështjes së vizave për kosovarët që duan të vijnë në Izrael, është një punë që jemi duke punuar dhe shpresojmë që brenda muajve të ardhshëm të kemi diçka konkrete në këtë drejtim.

Pas luftës në Ukrainë, e kemi parë edhe më shumë ndikimin e Kinës, Rusisë në Ballkan? Si e shihni këto zhvillime që kanë prekur Evropën?

Tamar Ziv: Të gjitha vendet janë

prekur nga kjo politikë globale që është krijuar pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia. Ballkani është i prekur nga kjo krizë, Lindja e Mesme, Lindja e Largët, pra, të gjithë jemi të prekur nga kjo krizë. Pra, kjo është një çështje e madhe në nivel botëror e që ka efektet e saj në pjesë të ndryshme të botës dhe në mënyra të ndryshme.

Pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy vendeve, në Kosovë është hapur edhe Korporata për Zhvillim dhe Investime Kosovë - Izrael. A është Kosova treg në të cilin do të investonin kompanitë izraelite?

Tamar Ziv: Po mendoj që po, sepse kompanitë izraelite tashmë veç kanë investuar në Kosovë, madje edhe para se të vendoseshin marrëdhëniet diplomatike ndërmjet dy vendeve. Ka mjaft sipërmarrës izraelitë që punojnë në Kosovë. P.sh: një fushë shumë interesante është ajo e energjisë së ripërtërishme ku një kompani izraelite së bashku me një kompani gjermane krijuan turbinat e erës, përmes të cilave krijohet energji në Kosovë. Pra mendoj që ka fusha të ndryshme që janë potencialë për investime, si p.sh: prodhimi i ujit, agrikultura, ndërtimet etj. Pra, shoh shumë mundësi të bashkëpunimit dhe zhvillimeve që mund të bëhen ndërmjet kompanive të të dyja vendeve.

Izraeli ka mbështetur disa organizata bamirësie në Kosovë. A do të vazhdojë kjo mbështetje në të ardhmen për Kosovën?

Tamar Ziv: Po mundohemi të bëjmë aq sa mundemi. Jam e lumtur që kemi arritur t'i dhurojmë 90 karrige për fëmijët me nevoja të veçanta. Mendoj që kjo është një iniciativë e mirë. Tani po mendojmë si do të punojmë në fusha të tjera, p.sh: me njerëzit me nevoja të veçanta. Tashmë veç jemi në kontakt me Ministrinë e Shëndetësisë për të punuar në këtë drejtim. Shpresoj që brenda muajve të tjerë ekspertët izraelitë do të arrijnë në Kosovë për të bashkëpunuar me Ministrinë e Shëndetësisë, në fusha të ndryshme. Pra, definitivisht jemi duke punuar në këto fusha.

Kurti: Spanja duhet dhe do ta njohë Kosovën

PRISHTINË, 19 GUSHT - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, gjatë qëndrimit në Bruksel, ka dhënë një intervistë për gazetën prestigjioze spanjolle "El País", ku ka folur për raportet në mes të Madridit dhe Prishtinës zyrtare.

Kurti ka thënë se Spanja duhet dhe do ta njohë Kosovën shtet. Kur e ka thënë një gjë të tillë, Kurti ka cituar edhe shkrimtarin e famshëm shqiptar Ismail Kadare, i cili kishte thënë se "Spanja s'duhet krahasuar kurrë me Serbinë, sepse Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë".

Shefi i Qeverisë së Republikës së Kosovës ka folur edhe për agresionin rus dhe përpjekjen e Moskës për ta rritur destabilizimin në kufijtë e Bashkimit Evropian. "Rusia bën presion për ta rritur jostabilitetin në kufijtë e BE-së", ka thënë Kurti.





SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) INKURAJOJNË KOSOVËN DHE SERBINË PËR VAZHDIMIN E DIALOGUT

ShBA-ja, Kosovës dhe Serbisë: Vazhdojini negociatat!

Takimi në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të enjten në Bruksel ka përfunduar pa ndonjë marrëveshje. Pavarësisht kësaj, ShBA-ja u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i vazhdojnë negociatat për arritjen e marrëveshjes përfundimtare. Zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) i ka inkurajuar Kurtin dhe Vuçiqin ta shfrytëzojnë dialogun në mënyrë efektive. Ai ka thënë se sekretari Blinken është i angazhuar personalisht në këtë proces

vëzhguar nga afër këto bisedime. Ju siguroj që këto bisedime e kanë vëmendjen e zyrtarëve të lartë amerikanë. Ambasadori ynë në BE është një nga zyrtarët që po e vëzhgon këtë nga afër. Por, ka zyrtarë të lartë që edhe këtu në Uashington po e bëjnë të njëjtën. Kjo është një çështje me të cilën vetë sekretari Blinken është angazhuar personalisht prej një kohe të gjatë. Ky është një prioritet që përfshinë gjithë organizatën tonë në terren dhe këtu në ShBA", ka thënë Price. Zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit nuk ka pranuar të përgjigjej nëse Shtëpia e Bardhë i ka dorëzuar një mesazh të enjten Bashkimit Evropian në lidhje me dialogun Kosovë Serbi, por ka thënë se "ne jemi të kënaqur që këto diskutime kanë filluar dhe po vazhdojnë edhe tani. Ne do të mbesim të përfshirë drejtpërdrejt me të dyja palët, me homologët tanë në Kosovë dhe Serbi si dhe përmes vëzhgimit të bisedimeve që po ndërmjetësohen nga BE-ja". Ndërsa përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, pas dy raundeve të takimeve me Kurtin dhe Vuçiqin, ka bërë me dije se Kosova dhe Serbia nuk kanë arritur një marrëveshje për çështjen e targave dhe dokumenteve serbe. Por, ai ka thënë se palët janë pajtuar që t'i vazhdojnë diskutimet në ditët

në vazhdim pasi, siç ka thënë ai, "ende ka kohë" dhe se BE-ja "nuk heq dorë" nga insistimi që dy shtetet të arrijnë kompromis. Borrelli ka thënë se takimet në Bruksel në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, me ndërmjetësimin e BE-së, nuk ishin "takime të zakonshme", por "takime për menaxhimin e krizës". "Ne pamë rritje tensionesh për vendimin e targave dhe dokumenteve. Komuniteti ndërkombëtar s'do të shohë eskalim të situatës dhe palët do të jenë përgjegjëse për të. Ne nuk arritëm marrëveshje sot, por s'është fundi i tregimit. Dy liderët (Kurti dhe Vuçiqi) u pajtuan se procesi duhet të vazhdojë dhe diskutimi do të rikthehet në ditët e ardhshme dhe ka kohë deri më 1 shtator", ka thënë Borrelli në një konferencë për medie, duke shtuar se të dyja palët do të jenë fajtorë nëse eshalon situata. "Të dyja palët do të jenë përgjegjëse për ndonjë eskalim të mundshëm", është shprehur Borrelli. Takimi i Brukselit është thirrur pasi serbët lokalë më 31 korrik dhe 1 gusht vendosën barrikada si shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për zbatim të dy vendimeve: për targat e makinave dhe dokumentet serbe. Kosova dhe Serbia kanë

marrëveshje për lëvizje të lirë prej vitit 2011. Serbia e ka zbatuar atë menjëherë. Kosova e ka zbatuar më 1 gusht - për pak orë - pikën për dokumentin për hyrje/dalje dhe e ka shtyrë zbatimin e vendimit për 1 shtator me qëllim të uljes së tensioneve në veri. Ndërkohë serbët i kanë hequr barrikatadat. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë kërkuar një shtyrje të tillë, ndonëse kanë thënë se Kosova ka të drejtë të zbatojë këto vendime.

Qeveria e Kosovës: Në takimin e Brukselit në agjendë ishin dy tema

Për takimin e Brukselit është deklaruar të enjten vonë edhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Qeveria në një deklaratë për medie ka theksuar se ky takim është dashur të mbahej më 19 korrik. Mirëpo, ai ishte shtyrë për muajin gusht me kërkesën e palës tjetër, derisa kryeministri Albin Kurti pati shprehur gatishmërinë për pjesëmarrje. Qeveria e Kosovës ka njoftuar se në takimin e Brukselit kanë qenë në agjendë dy tema. "E para ishte diskutimi për kornizën e përgjithshme të marrëveshjes. Kryeministri Kurti theksoi që kjo marrëveshje duhet të jetë ligjrisht e obligueshme për normalizimin e plotë të marrëdhënieve me njohje

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 19 GUSHT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) u kanë bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë ta vazhdojnë dialogun, pasi takimi mes palëve në Bruksel të enjten ka përfunduar pa ndonjë rezultat. Zëdhënësi i Departamentit të Shtetit (DASH), Ned Price, ka thënë se Uashingtoni zyrtar është duke e ndjekur me vëmendje dhe përparësi procesin e dialogut në mes të dy shteteve. "Nga ajo që dimë është se bisedimet po vazhdojnë. Ne, në partneritet me BE-në, po e ndjekim me kujdes dhe inkurajojmë të dyja palët që ta shfrytëzojnë dialogun në mënyrë efektive dhe u sugjerojmë palëve që ta vazhdojnë dialogun", ka thënë Price. Zëdhënësi i Departamentit të

Shtetit ka theksuar se Uashingtoni e përkrah në tërësi dialogun dhe tha se është me rëndësi që të dyja palët të shfrytëzojnë këto bisedime në mënyrë efektive, duke përsëritur qëndrimin e Uashingtonit se atë duhet ta "çojnë përpara diskutimin për normalizim marrëdhëniesh që ka në qendër premisën e njohjes së ndërsjellë". Price ka thënë se emisari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, krahas ambasadorit të ShBA-së në BE, Mark Gitenstein, janë duke i vëzhguar diskutimet nga afër në mes të Prishtinës dhe Beogradit dhe ka shtuar se sekretari i Shtetit, Antony Blinken, është i angazhuar personalisht. "Janë një mori zyrtarësh të lartë që po e vëzhgojnë këtë çështje nga afër. E kemi një zyrtar të lartë që është në Bruksel duke i

reciproke në qendër. Ai prezantoi disa kapituj me elemente përkatëse që duhet t'i përmbajë kjo kornizë. Tema e dytë ishin çështjet aktuale politike e të sigurisë për të cilat kryeministri Kurti tregoi për rëndësinë e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë në vendin tonë si garancinë e paqes, sigurisë dhe barazisë për të gjithë qytetarët pa dallim", ka njoftuar qeveria Kurti.

Në këtë njoftim është theksuar se kryeministri Kurti ka falënderuar Bashkimin Evropian, Borrelin dhe Lajçakun për organizimin dhe ndërmjetësimin në këto bisedime, drejt normalizimit të marrëdhënieve bilaterale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Ndërsa presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se 18 gushti ka qenë ditë e vështirë në Bruksel, por do të përmbahet nga çdo koment. Ai u është referuar takimeve me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, nën ndërmjetësim të Bashkimit Evropian. "Një ditë e vështirë është prapa nesh. Ishte një ditë e vështirë për të gjithë qytetarët dhe për mbarë vendin tonë. Nuk mund të them se ka përfunduar me sukses, por përmbahem nga komentet e tjera, sepse shpresoj se është e mundur që me ndonjë mrekulli të arrijmë një zgjidhje kompromisi. Prandaj do të vazhdoj të luftoj për paqe dhe stabilitet", ka thënë Vuçiqi.

Vuçiqi do t'u drejtohet qytetarëve serbë të dielën edhe pse ishte paralajmëruar se një gjë të tillë do ta bënte të premtën. Kështu ka bërë me dije drejtori i së ashtuquajturës Zyrë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviç. Sipas tij, Serbia është duke e bërë të pamundurën për të gjetur një zgjidhje kompromisi. "Presidenti e shtyu fjalimin e tij sepse nuk mund të pajtohet me faktin se nuk kemi zgjidhje... Sepse nuk mund të pajtohet me faktin se ne kemi konflikte në 'Kosovë dhe Metohi', prandaj gjatë gjithë ditës së djeshme, por edhe mëngjesin e sotëm, ai po

punon për gjetjen e një zgjidhjeje. Presidenti Vuçiq të dielën do të flasë për gjithçka, për dialogun, për detajet, për propozimet, se si është sjellë (kryeministri i Kosovës) Kurti, si dhe çfarë duhet të bëjmë për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin, për ta ruajtur jetën e popullit tonë në Kosovë", ka thënë Petkoviç, duke shtuar se Kosova nuk i ka pranuar propozimet e Serbisë për targarat dhe dokumentet.

Scholzi dhe Macroni i kanë kontaktuar Kurtin dhe Vuçiqin para takimit

Duke u thirrur në burime diplomatike në Bruksel, "Radio Evropa e Lirë" ka raportuar se kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz dhe presidenti i Francës, Emanuel Macron, i kanë kontaktuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, para takimit. Sipas këtyre burimeve, ata i kanë kontaktuar për t'i inkurajuar për arrijtjen e një marrëveshjeje dhe për evitimin e përshkallëzimit të situatës. "Shumë liderë ndërkombëtarë kanë shprehur pritjet e tyre nga takimet e këtyre dy liderëve. Këtë e kanë kuptuar edhe vetë liderët. Edhe pse nuk patëm marrëveshjeje për rrugën finale sesi të adresohet çështja, procesi po vazhdon", citohet të kenë thënë burimet brenda BE-së.

Molliqaj: Kurti e heshti ripërcaktimin e kufijve, por po e kthen fuqishëm asociacionin



19 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, ka thënë se Albin Kurti e heshti ripërcaktimin e kufijve por, sipas tij, është duke e kthyer fuqishëm Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. "Pa projekt e pa vizion, kështu janë ato personazhet që rriten nga dëshimet e të tjerëve dhe përfitojnë nga puna e tjerëve. Kështu duket vazhdimësia. Fakti që ai u bë pjesë e këtij procesi, ku pozicionet e tij janë marrëveshjet e vitit 2011, nënkupton lëshim pe. Dhe jo që pozicionet e kaluara duhen mbajtur për ta ruajtur 'fjalën e thënë', por sepse pozicionet e reja të tij janë të vjetra dhe të dëmshme për Kosovën", ka shkruar Molliqaj në

llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka theksuar se "a nuk erdhi Kurti në pushtet pikërisht duke kundërshtuar kornizat mbi të cilat zhvillohej dialogu? Por, siç po dëshmohej çdo ditë, ardhja e Kurtit në pozitë pushteti nuk është ndonjë ngjarje historike. Ai mbetet i frikësuar në lëvizhat e projektit të vjetër të asociacionit". Molliqaj ka theksuar se Kurti, si luftëtar i paepur kundër ripërcaktimit të kufijve, njëmend e heshti këtë ide. "Ama në vend të kësaj ideje, që është zgjidhja e vetme e qëndrueshme për paqe të përhershme, ai e ringjalli fuqishëm idenë Asociacionit me kriterin etnik. Brenda idesë së defunksionalizimit të brendshëm të Kosovës, që për më tepër nuk

do të sigurojë as njohje e as ulëse në OKB. "Mungesa e vizionit për dialogun është prania e tepruar e vetes, deri në verbëri brenda tij dhe rreth tij. Asnjë zgjidhje e qëndrueshme nuk do të vijë për sa kohë shikimi nuk shkon kah e ardhmja. Llogaritë e Kurtit për ta zbatuar Asociacionin janë llogaritë e frikës për pushtetin e tij", ka shkruar Molliqaj, duke shtuar se konflikti me Serbinë mbetet te dera. "Kostoja e asociacionit kushton më pak vota, thotë ai. Konflikti mbetet te dera sërish. Politika e ka të garantuar edhe në të ardhmen një armik të jashtëm që shtrin tentakulat dhe gjeneron bashkëpunëtorë - armiq të brendshëm", ka shkruar Molliqaj.

Haradinaj, BE-së: Është koha ta dorëzoni dialogun te Bideni

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar në lidhje me takimin ndërmjet kryeministrin të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të mbajtur të enjten në Bruksel me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian (BE).

Haradinaj nëpërmjet një shkrimi të publikuar në "Facebook" ka thënë se dialogu i deritashëm nuk bën të zbehet e të kthehet mbrapa e të bisedohet për temat e njëjta. "Zbatimi i rendit dhe ligjit në tërë vendin duhet të ndodhë në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Kosovës. Dialogu i

deritashëm nuk guxon të zbehet e të rikthehem prapë të flasim për të njëjtat tema", ka shkruar Haradinaj.

Ai i ka shprehur mirënjohje BE-së për lehtësimin e dialogut por, siç është shprehur ai, është momenti që BE-ja ta dorëzojë portofolin të presidentit amerikan Joe Biden. "Amerika kësaj here i dha shtytje procesit të udhëhequr nga BE-ja dhe ndihmoi dhe e riktheu normalitetin në raportet Kosovë - Serbi. Duke i shprehur mirënjohje Bashkimit Evropian për lehtësimin e dialogut, është momenti i duhur që BE-ja ta dorëzojë portofolin të presidentit Biden për marrëveshjen finale për njohje reciproke Kosovë - Serbi", ka shkruar Haradinaj.



Miftaraj paralajmëron se Ligji i ri i Pagave mund të rrëzohet sërish nga Kushtetuesja

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Para pak ditësh ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka njoftuar se është proceduar Projektligji për Pagat dhe Projektligji për Zyrtarët Publikë. Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv në Institutin e Kosovës për Drejtësi, ka reaguar pas procedimit të këtyre dy projektligjeve. Miftaraj ka thënë se në lexim të parë dhe pa bërë analiza të thella, Projektligji për Pagat nuk e kalon filtrin e Gjykatës Kushtetuese. "Draftligji për Pagat: Në lexim të parë dhe pa bërë analiza më të thella, me kushtin që koeficienti është 120 euro, sikurse po theksohet në publik dhe nëse draftet e ligjit dhe dokumentet përcjellëse që kanë dalë në publik janë dokumente që do

të dalin në konsultim publik, draftligji aktual nuk e kalon filtrin e Gjykatës Kushtetuese", ka thënë ai.

Më tutje, Miftaraj ka shtuar se me projektligjin aktual ulen ndjeshëm pagat e prokurorëve, gjykatësve dhe kjo qasje, sipas tij, cenon sigurinë juridike. "Me draftligjin aktual ulen ndjeshëm pagat e prokurorëve, gjykatësve të gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese, shërbimit diplomatik etj. Një qasje e tillë cenon sigurinë juridike dhe financiare të secilit zyrtar publik që i zvogëlohet paga. Nëse nuk ndryshojnë koeficientet, nuk ndryshohet krejtësisht qasja në këtë hartimin e këtij ligji, i njëjti është hartuar për të mos hyrë



në fuqi, ose edhe mund të fitohet besimi se drafti aktual është për të blerë kohë. IKD-ja

do të marrë pjesë në konsultime publike dhe do të të hartojë dhe publikojë raporte

analitike për dy draftligjet, për Paga dhe Zyrtarët Publikë", ka thënë Miftaraj.

Prokuroria Speciale heton "organizatat ilegale" nga Serbia që veprojnë në Kosovë

PRISHTINË, 19 GUSHT - Policia e Kosovës ka informacione se në territorin e Kosovës veprojnë "grupe apo organizata ilegale" nga Serbia, ndërsa Prokuroria Speciale në Prishtinë është duke zhvilluar hetime ndaj disa prej tyre. Lajmin e ka konfirmuar Policia e Kosovës në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë". Megjithatë, ky institucion nuk ka dhënë informata për këtë çështje për shkak të hetimeve të Prokurorisë. "Policia e Kosovës, në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera të sigurisë në Kosovë, por edhe me partnerët ndërkombëtarë, trajton të gjitha të dhënat lidhur me grupet ilegale që mund ta cenojnë rendin dhe sigurinë publike", është thënë në përgjigjen e Policisë së Kosovës. Ndërsa Prokuroria Speciale nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion. Kryeministri i Kosovës, Albin



Kurti, pati thënë në fund të marsit se rreth dhjetë organizata të ekstremit të djathtë nga Serbia po përpiqen ta destabilizojnë situatën e sigurisë në Kosovë, por ai nuk pati dhënë informacione të

tjera. Kurti ka thënë se këto grupe aktivizohen publikisht në festa, siç është 28 qershori, kur shënohet Beteja e Kosovës e vitit 1389. Në lidhje me këtë çështje, Ministria e Punëve të

Brendshme nuk u është përgjigjur pyetjeve të "REL"-it në kërkesën për ta marrë listën e organizatave për të cilat ka folur Kurti, dhe as nëse në Kosovë ndalohet aktiviteti i organizatave të djathta nga

Serbia.

Ismail Hasani, sociolog nga Prishtina, dhe Predrag Petroviq nga Qendra për Politika të Sigurisë në Beograd, kanë vlerësuar se grupet e djathta nga Serbia mund të kontribuojnë në rritjen e tensioneve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe të sjellin trazira dhe shqetësim shtesë mes njerëzve.

Të dy ekspertët kanë nënvizuar se aktivitetet e grupeve të ekstremit të djathtë nga Serbia janë të lidhura me luftën në Ukrainë, e cila filloi në fund të shkurtit, pasi presidenti rus, Vladimir Putin, urdhëroi atë që e quan "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Autoritetet e Kosovës kanë thënë në disa raste se Serbia është "sateliti i Rusisë" dhe se Beogradi dhe Moska po punojnë për destabilizimin e Ballkanit Perëndimor.

KFOR-i shton aktivitetet në veri, shton praninë në pikat kufitare Jarinjë e Bërnjak

PRISHTINË, 19 GUSHT - KFOR-i ka njoftuar se ka shtuar aktivitetet patrulluese në pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak që të reagojë shpejt ndaj të gjitha sfidave të sigurisë. Po ashtu, KFOR-i ka njoftuar se këto masa janë marrë për të mundësuar të reagojë shpejt ndaj të gjitha sfidave të sigurisë. "Ne duam të sigurojmë të gjithë se KFOR-i është i gatshëm të ndërhyjë nëse është nevoja",

është thënë në përgjigjen e zyrës për medie të KFOR-it për "Dukagjinin".

Sipas kësaj përgjigjeje, KFOR-i ka thënë se në mandatin që ka me Rezolutën 1244 të vitit 1999, do të ofrojë një ambient të sigurt dhe liri të lëvizjes për gjithë qytetarët e Kosovës. Ndryshe, më 31 korrik, serbët lokalë në veri të vendit kishin vendosur barrikada në rrugët që çojnë në pikat kufitare me

Serbinë, në Jarinjë dhe në Bërnjak, si revoltë ndaj vendimit të 29 qershorit të Qeverisë së Kosovës për reciprocitet ndaj Serbisë për targa dhe dokumentet hyrje-dalje.

Këto barrikada ishin larguar pas shtyrjes së këtij vendimi deri më 1 shtator nga Qeveria e Kosovës, vendim ky që ishte në koordinim me aktorët ndërkombëtarë.



Beogradi jep miliona euro për kompanitë energjetike serbe në Kosovë

PRISHINË, 19 GUSHT - Kompania energjetike e Serbisë "Elektroprivreda Srbije (EPS) është themeluese e katër kompanive nga Kosova, por aktualisht asnjëra prej tyre nuk kryen aktivitetin për të cilin është themeluar. Në këto kompani janë të punësuar rreth 3 300 punëtorë dhe EPS-ja ka ndarë rreth 42 milionë euro për punën e tyre në vitin 2021.

Në një raport për problemet në sektorin energjetik në Serbi në korrik të vitit 2022, Këshilli Fiskal i Serbisë deklaroi se EPS-ja vetëm i "mbështet" ata punëtorë, pasi nuk ka kontroll mbi asetet dhe operacionet e kompanive nga Kosova. E vetmja kompani që ka licencë për të punuar në Kosovë është "Elektroseveri", e cila ende nuk është funksionale.

Kompania "Elektrosever" është kompania më e re e EPS-së në Kosovë. Ajo është themeluar në vitin 2016 me qëllim të furnizimit dhe faturimit të energjisë elektrike në komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe.

Që nga viti 1999 banorët e komunave në veri të Kosovës, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, nuk i kanë paguar faturat për energjinë e konsumuar. Sipas të dhënave të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (KOSTT), humbjet vetëm për vitin 2021 arritën shumën prej 40 milionë eurosh.

Që nga viti 2017, sipas autoriteteve të Kosovës, borxhet për energji elektrike janë mbuluar nga KOSTT-i, gjegjësisht Qeveria e Kosovës. Deri atëherë borxhin për veriun e paguanin paushall qytetarët e Kosovës nga komunat e tjera në jug të Ibrit, kështu që faturat e tyre ishin më të larta për 3.5 për qind, por u konstatua se kjo praktikë ishte e kundërligjshme. Themelimi i "Elektrosever"-it ishte paraparë me Marrëveshjen për Energjinë të vitit 2013 dhe 2015 ndërmjet Serbisë dhe Kosovës dhe kompania është themeluar në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative të Kosovës.

Kosova dhe Serbia më 21 qershor të vitit 2022 në Bruksel kanë miratuar udhërrëfyesin për zbatimin e marrëveshjes. Në bazë të asaj marrëveshjeje, më 24 qershor Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE) i ka lëshuar licencën për furnizim kompanisë "Elektrosever". Mirëpo, siç ka raportuar "REL"-i në korrik, "Elektrosever" ende nuk i ka ofruar Kompanisë për Distribucionin e Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) dhe KOSTT-it të dhënat që ka në dispozicion për konsumatorët në veri të Kosovës.

"Elektrosever"-i, gjithashtu, nuk i ka nënshkruar ende

marrëveshjet e nevojshme teknike me KEDS-in dhe KOSTT-in, për të operuar në tregun për energji të Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë në një intervistë për "REL"-in në gusht, se kjo tregon se Serbia nuk i respekton obligimet e saj. "I kemi pasur dy javë për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë që ta bëjë licencimin e kompanisë në veri. E ka bërë për dy ditë. Ndërkaq edhe sot, pas shumë e shumë javëve, që është dashur të na dorëzohet regjistri i fundit i konsumatorëve në veri, Serbia nuk e ka bërë", ka deklaruar Kurti.

EPS-ja nuk i ka kthyer përgjigje "REL"-it nëse "Elektrosever"-i ka nisur punën dhe se kur do t'i dorëzojë të dhënat e nevojshme dhe të nënshkruajë marrëveshjet me institucionet e Kosovës.

Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë parasheh që "Elektrosever"-i të marrë përgjegjësitë e "Elektrokosmet"-it, një tjetër kompani që funksionon në kuadër të kompanisë energjetike të Serbisë. "Elektrosever"-i është e regjistruar në të njëjtën adresë në Mitrovicën e Veriut në Kosovë, si seli e përkohshme e "Elektrokosmet"-it, kompani e cila ekziston që nga viti 1989. "Elektrokosmet"-i dhe EPS-ja nuk i janë përgjigjur pyetjes së "REL"-it nëse planifikohet mbyllja pasi "Elektrosever"-i t'i marrë përgjegjësitë e asaj kompanie.

Sipas marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, punëtorët e "Elektrokosmet"-it ose do të punësohen në kompaninë e re, ose mund t'u ofrohet punësim në KEDS.

Kjo kompani në vitin 1999, pas luftës në Kosovë, siç pretendohet në raportin vjetor të biznesit të vitit 2021, ka humbur kontrollin mbi kapacitetet e saj energjetike në Kosovë, përveç në veri.

Në fund të vitit 2009 kompania ["Elektrokosmet"] filloi leximin dhe dërgimin e faturave të energjisë elektrike në veri të Kosovës, të cilat autoritetet e Kosovës i konsiderojnë të paligjshme për shkak se kjo kompani nuk ka licencë për t'u angazhuar në këtë aktivitet. Prandaj qytetarët e veriut të Kosovës nuk ishin të obliguar t'i paguanin ato.

Në raportin e kompanisë mund të gjenden edhe informacione se nga viti 2020 "Elektrokosmet" do ta furnizojë vetëm komunitetin lokal të Leshakut dhe Trepçës në Leposaviq, që përbën rreth 13 për qind të sipërfaqes së pjesës veriore të Kosovës, ku popullsia furnizohet me energji elektrike.

Që atëherë, kompania nuk ka lëshuar as faturat e energjisë elektrike pasi, siç pretendojnë në raport, që nga ai vit energjia nuk



merret më nga sistemi i EPS-ot, por nga KOSTT-i. Nga viti 2020 KOSTT-i punon në mënyrë të pavarur dhe kontrollon kufijtë energjetikë të Kosovës.

Kompania "Elektrokosmet", edhe pse është e regjistruar për dërgimin dhe faturimin e energjisë elektrike, në raport theksohet se pjesën më të madhe të të ardhurave nuk e realizon në këtë mënyrë, por duke ofruar shërbime për sektorë të caktuar të EPS-së. Kompania ka 464 punonjës dhe në vitin 2021 ka funksionuar me një humbje prej 6.8 milionë eurosh. Përveç "Elektrokosmet-it", EPS-ja është themeluese e dy kompanive të tjera nga Kosova që nuk janë marrë me aktivitetin për të cilin janë themeluar me dekada dhe po operojnë me humbje. Selia e tyre është në Beograd.

Që nga viti 1999 kompania publike Termocentrali "Kosova" nuk operon në territorin e Kosovës dhe nuk ka kontroll mbi termocentralet në këtë shtet. Ndonëse është e regjistruar për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, kjo kompani ka më shumë se 700 punonjës të cilët, siç thuhet në faqen e kompanisë, merren me montimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme për sektorët e EPS-së.

Humbjet e kompanisë për vitin 2021 ishin 11.5 milionë euro.

Në vitin 2021 edhe kompania "Minierat sipërfaqësore të Kosovës" ("Površinski kopovi Kosovo") shënoi humbje prej rreth 2.8 milionë eurosh. Ajo është regjistruar në vitin 1991 për shfrytëzimin e linjtit dhe qymyrit të murrme, gjithashtu që nga viti 1999 nuk ka kontroll mbi minierat në Kosovë dhe nuk është e angazhuar në aktivitetin e saj kryesor. "Një numër i madh punëtorësh janë të punësuar në EPS dhe kompanitë që ajo i ka themeluar, për riparime të pajisjeve të energjisë termike, mirëmbajtje të vazhdueshme, menaxhim të makinerive në funksion...", është thënë në raportin vjetor të kompanisë për vitin 2021.

Në korrik, Këshilli Fiskal i Serbisë, një organ i pavarur shtetëror, është marrë me punën e kompanive të

përmendura në raportin e titulluar: "Problemet strukturore të energjisë serbe në dritën e krizës globale: shkaqet, kostot dhe zgjidhjet e mundshme". Në raportin e Këshillit Fiskal thuhet se EPS-ja ka shpenzuar 45 milionë euro në vitin 2020 për pagat e punonjësve të këtyre kompanive (me përjashtim të "Elektrosever"-it, e cila nuk ka funksionuar dhe nuk është përfshirë në raport), dhe rreth 42 milionë euro në vitin 2021. Bëhet fjalë për 3 300 punëtorë, sipas të dhënave në fund të vitit 2020.

"Nga pikëpamja e EPS-së, këto shpenzime paraqesin një kosto të pastër", është thënë në raport dhe shtohet se kjo është për shkak se punëtorët në Kosovë de fakto "nuk kontribuojnë në proceset e prodhimit në kompani".

Në raport, po ashtu, është thënë se financimi i këtyre kompanive është barrë për EPS-në sepse ajo, pas vitit 1999, nuk ka pasur kontroll mbi asetet dhe operacionet e këtyre kompanive.

Sllobodan Miniq, këshilltar special i Këshillit Fiskal, i cili ka punuar në raportin e lartpërmendur, po ashtu thotë se ka dyshime edhe për ligjshmërinë e pagesave të pagave për punëtorët nga Kosova. "E gjithë situata me pagesat e pagave për punëtorët në Kosovë ka dalë në Gjykatën Kushtetuese dhe ato pagesa janë shpallur të kundërligjshme. Nuk jemi në dijeni nëse në ndërkohë është gjetur një zgjidhje alternative ligjore në bazë të së cilës EPS-ja vazhdon t'i paguajë ata", ka thënë Miniq.

Përkatesisht, pagat për punëtorët nga Kosova që punojnë në shërbime publike paraprakisht janë paguar në bazë të Konkluzionit të Qeverisë së Serbisë të vitit 2003, dhe konkluzioni parasheh paga më të larta për punëtorët nga Kosova në krahasim me të punësuarit në kompanitë në Serbi, me shpjegimin se janë "në pozitë të pabarabartë me qytetarët e tjerë".

Ky konkluzion u kundërshtua nga Gjykata Kushtetuese e Serbisë në vitin 2010, duke theksuar, ndër të tjera, se masa të tilla mund të merren vetëm

me ligj.

"REL"-i nuk ka marrë përgjigje nga EPS-ja dhe kompanitë e saj se në bazë të cilës rregullore ua paguan pagat punëtorëve nga Kosova.

Miniq ka thënë se për momentin EPS-ja ka problem edhe me punëtorët e tepert, të cilët përbëjnë rreth 10 për qind të numrit të përgjithshëm të të punësuarve.

"Është e vështirë të vlerësohet nëse të gjithë punëtorët [në kompanitë nga Kosova] janë tepriçë apo nëse disa prej tyre mund të gjejnë punësim të përhershëm në EPS. Kjo është arsyeja pse ne rekomanduam në raport që të gjenden zgjidhje për ato kompani", ka thënë ai.

"Radio Evropa e Lirë" ka njohuri se disa punëtorë të EPS-së në zonat e banuara me serbë në Kosovë janë vetëm në listën e pagave, por nuk janë të punësuar, gjë që ua mundëson atyre që të punojnë pa probleme në sistemin e Kosovës.

Të dy sistemet, në Serbi dhe në Kosovë, nuk e njohin njëri-tjetrin, pra nuk ka asnjë bashkëpunim apo pasqyrë të administratës.

Nga ana tjetër, ka edhe nga ata që punojnë për një periudhë të caktuar kohore nëpër qytete të Serbisë.

"REL"-i ka tentuar të marrë deklaratë nga këta punëtorë, por ata nuk kanë dashur të flasin publikisht.

Duke financuar kompanitë që nuk angazhohen në aktivitetet për të cilat është themeluar EPS-ja, ajo bëhet peng i politikës, beson Miniq.

"Është një problem më i gjerë politik dhe social që mbetet në kuadër të EPS-së për ta trajtuar atë. Nëse ka punëtorë që nuk kontribuojnë në proceset e prodhimit të EPS-së, do të ishte një zgjidhje më e pastër që shteti të hartonte një program social për ata persona jashtë bilancit të EPS-së", ka theksuar ai.

Me humbje është duke operuar edhe Kompania Energjetike e Serbisë, humbje të cilat në 2021-n arritën shifrën rreth 141 milionë eurosh.

Ministria e Minierave dhe Energjetikës e Serbisë nuk i është përgjigjur pyetjes së "REL"-it se si dhe kur pritet të zgjidhet statusi i kompanisë EPS nga Kosova.

Kosova dhe Serbia kanë nisur dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me

ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian 11 vjet më parë. Palët arritën një marrëveshje për energjinë në vitin 2013, ndërsa në vitin 2022 miratuan udhërrëfyesin për zbatimin e marrëveshjes për energjinë.

Më 9 gusht Bashkimi Evropian deklaroi se zbatimi i Udhërrëfyesit po vonohet dhe fajin për këtë ua la "teknikaliteteve".

Shkurtimet e rrymës e detyrojnë Ambasadën Amerikane të kërkojë mirëmbajtës gjeneratori

PRISHTINË, 19 GUSHT - Pas shkurtimeve të rrymës, qytetarët e Kosovës po i plotësojnë nevojat edhe me metoda alternative. Nga ky problem është prekur edhe Ambasada Amerikane, e cila së fundi ka hapur një pozitive për të punësuar një

mbikëqyrës të mirëmbajtjes së gjeneratorit. "Jemi duke punësuar! Ambasada Amerikane në Prishtinë është duke kërkuar që të punësojë një mbikëqyrës të mirëmbajtjes së gjeneratorit dhe ndihmës hidraulik", është thënë në shpalljen e

Ambasadës Amerikane. Për ta menaxhuar krizën me rrymë, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike në Kosovë (KOSTT) ka thënë se instruksionet për reduktime të rrymës do të mbesin në fuqi deri në stabilizimin e situatës.



Ndërprerjet e energjisë po dëmtojnë bizneset, paralajmërohet mbyllja e tyre

PRISHTINË, 19 GUSHT - Ndërprerjet e vazhdueshme të energjisë elektrike ditët e fundit e kanë vështirësuar punën në sektorin e gastronomisë. Ky sektor që ka qenë më i sulmuar nga pandemia e që nuk e ka pasur ndihmën e duhur nga shteti do të pësojë edhe më shumë, ka thënë kryetari i Odës së Hotelerisë dhe Turizmit në Kosovë, Hysen Sogojeva. Ai ka thënë se do të ketë rritje të çmimeve, duke theksuar se nëse vazhdon zgjatja e orarit pa rrymë, atëherë do të vijë deri te mbyllja e një numri të konsiderueshëm të tyre. "Vetë fakti që kjo veprimtari ka qenë më e atakuar gjatë kohës së pandemisë, pastaj nuk është ndihmuar fare ashtu qysh kanë qenë parashikimet, tash ndalja dhe paraqitja e problemit me rrymë, ndikon që kjo veprimtari të jetë shumë e rrezikuar në të ardhmen. Vetë fakti që kemi rritje të çmimeve në çdo

produkt është shumë normale tash edhe me harxhimin që e bëjnë me gjeneratorë që të kemi rritje të çmimeve. Nëse kemi rritje të madhe të çmimeve atëherë klientela mund të largohet. Shumica e bizneseve sot në Kosovë, nëse vazhdohet kështu dhe ka zgjatje të orarit pa rrymë, vjen deri te mbyllja e një numri të konsiderueshëm të tyre", ka thënë Sogojeva për "EO". Ndërsa pronari i "MonReve", Veton Berisha, ka thënë se shpreson që të bëjë zgjidhje shteti sa i përket energjisë elektrike, duke paralajmëruar shtrenjtim të çmimeve. "Vetëm sa ka filluar ndërprerja. Shumë problem. Nuk mund t'i përgatitesh as kafe. Klientët janë të pakënaqur. Shpresoj të mos zgjasë më shumë kjo ndërprerje. Nëse do të kemi probleme me rrymë, do të kemi shumë probleme në dimër", ka thënë Berisha.



Procedohen 7 milionë euro për bujqit e Kosovës



PRISHTINË, 19 GUSHT - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Faton Peci, ka njoftuar se të premtën është proceduar pagesa e radhës për subvencionet e bujqve. 7 milionë euro janë proceduar. Do të përfitojnë 5 715 bujq. Peci ka thënë se po e përmbysim javën me mbi 12 milionë euro të proceduara për pagesë për 8 006 bujq. "E përmbysim javën me 12 128 781 73 milionë euro të proceduara për pagesë për 8 006 bujq, përfitues të

Programit për pagesa direkte/subvencione 2022 për çdo kulturë bujqësore. Vlera e proceduar për pagesë është rreth 7 milionë euro, ndërsa numri i bujqve që do t'i përfitojnë këto mjete është 5 715. Duke qenë se afati për sasinë e dorëzuar të grurit është data 2 shtator, edhe pagesën për këtë sasi, në vlerë prej 0.03 euro/kg, MBPZHR - AZhB do ta bëjë pas kësaj date si pagesë të veçantë për të gjithë aplikuesit e kulturës së grurit që dëshmojnë sasinë e dorëzuar të grurit, bazuar në

kriteret e parapara me Programin e Pagesave Direkte 2022, konkretisht Udhëzimin Administrativ nr. 02/2022. Dëshmia për sasinë e dorëzuar të grurit dorëzohet në drejtoritë komunale për bujqësi në komunat përkatëse deri më 2 shtator 2022 në orën 16:00. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë po vazhdon shtypjen e vendimeve për të tjerë bujq përfitues dhe në momentin e procedimit për pagesë të listës së radhës, do t'ju mbajmë të informuar", ka njoftuar Peci.

Qeveria i rekomandon KEK-ut t'i shfrytëzojë 7 milionë eurot e subvencionimit për energjinë

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se ka pranuar disa rekomandime nga Komiteti Teknik për Energji për të siguruar energji elektrike. Sipas njoftimit, rekomandimi kryesor është që KEK-u t'i shfrytëzojë mjetet e mbetura (rreth 7 milionë euro) nga subvencionet i bartur nga Qeveria e Kosovës për import të energjisë elektrike për ta mbuluar kërkesën vendore, pra me qëllim të

furnizimit të pandërprerë dhe eliminimit të devijimeve. "Aktualisht, KEK-u është duke punuar intensivisht me Ministrinë e Ekonomisë për finalizimin e marrëveshjes për jetësimin e rekomandimeve të Komitetit Teknik të Energjisë. Për më tepër, në kohën kur në vendin tonë rritet konsumi, KEK-u po vazhdon të pranojë një sasi të caktuar të energjisë elektrike nga Korporata Elektroenergjetike e Shqipërisë

(KESH). Kjo sasi po merret nga depozitimi që KEK-u kishte bërë për disa muaj në KESH dhe po vazhdon të depozitohet sa herë që KEK-u ka teprica e gjithë kjo me qëllim të furnizimit të konsumatorëve dhe evitimin e reduktimeve. Në këtë drejtim, KEK-u deri më tani ka depozituar mbi 120 000 MWh, ndërsa gjatë katër ditëve të fundit nga KESH-i kemi pranuar rreth 3 500 MWh", ka njoftuar KEK-u.



Pse Trump i mori me vete në shtëpi dokumentet e klasifikuara?



Nga Timothy L. O'Brien
"Bloomberg"

Tashmë e dimë se arsyeja pse Byroja Federale e Hetimit (FBI) kontrolloi rezidencën e Donald Trump në Palm Beach javën e kaluar, është sepse presidenti i 45-të i SHBA-së është nën hetim për grumbullimin e dokumenteve të klasifikuara në lidhje me armët bërthamore dhe ndoshta edhe shkëlqes së Aktit të Spiunazhit.

Po ashtu, ai mund të ketë gënjyer edhe zyrtarët federalë mbi këto dokumente, dhe të ketë penguar punën e organeve të drejtësisë. Pjesa më e madhe e zhurmës që pasoi lajmet e kontrollit të FBI-së, u përqendrua tek motivet e hetuesve për zbatimin e një urdhri të tillë në Mar-a-Lago. Kjo kryesisht sepse Trump e fokusoi vëmendjen tek akti në vetvete, duke shfrytëzuar një boshllëk komunikimi të krijuar nga Departamenti i Drejtësisë, që në fillim nuk sqaroi si duhet publikun rreth hetimit mbi ish-presidentin. Trump nuk është i sofistikuar apo shumë i zgjuar, por mesazhet janë një nga "superfuqitë" e tij.

Sapo e çlësoi kontrollin e FBI-së në rezidencën e tij, si një akt të motivuar politikisht dhe të denjë për "vendet e botës së tretë", avokatët e tij në Partinë Republikane dhe mbështetësit e tij mediaticë në Fox Neës, shkuan në punë duke përsëritur të njëjtat gënjeshtër. Mosfunksionimi i mundshëm i FBI-së, u bë një temë qendrore e debatit rreth kontrollit të banesës së Trump. Edhe analistët me të paanshëm nisën të kenë dyshime: "Hmm... Ndoshta

FBI-ja ka dalë nga binarët!". Por zhvillimet e mëvonshme, dhe një konferencë shtypi e Prokurorit të Përgjithshëm, Merrick Garland, e ripërqendruan siç duhet vëmendjen te autori i dyshuar – Trump – dhe kanë zbehur disa nga trillimet që synojnë të përbaltin FBI-në.

Shumëkush ka të drejtë të vazhdojë të shqetësohet mbi tejkalimin e mundshëm të kompetencave nga FBI. Por nevojiten përgjigje më të ngutshme se pse Trump u largua nga Shtëpia e Bardhë duke marrë me vete dokumentet sekrete. Unë mendoj se ekzistojnë 3 arsye të mundshme, pse Trump donte t'i mbante me vete të gjitha ato dokumente tepër sekrete dhe të klasifikuara.

Arsyeja e parë duket relativisht e padëmshme. Trump është si një "7-vjeçar i rritur", dhe atij i pëlqyen disa nga mjetet që që ke në dorë kur je president. Thuhet se ai donte të mbante me vete një model në miniaturë të "Air Force One". Ndër dokumentet e diskutueshme që u gjet në Mar-a-Lago ishte një hartë meteorologjike e uraganit Dorian.

Pse ajo hartë ishte kaq e rëndësishme për të? Kujt i interesonte ajo? Arsyet e dyta dhe të treta nuk janë aspak të padëmshme. Ato janë thellësisht të dëmshme dhe shqetësuese. Arsyeja e dytë: paratë. Lakmia e pakufizuar e ka motivuar gjithë jetën Donald Trumpin. Ai nuk u bëpjesë e biznesit të kazinove, vetëm për të zburuar Atlantic City.

Ai nuk propozoi një megazhullim në zonën East Side të Manhattan, vetëm sepse donte

ta bënte Nju Jorkun më të jetueshëm. Ai nuk themeloi Universitetin Trump për të edukuar studentët, dhe nuk drejtoi reality shoë "The Apprentice", vetëm për t'u mësuar të rinjve si të bëhen sipërmarrës të sukseshëm.

Dhe nuk garoi për president për ta rigjallëruar demokracinë amerikane. Arsyeja ishin paratë dhe vetëm paratë. Edhe ish-zyrtarë e tjerë të administratës Trump kanë fituar para në mënyra që duhet të ngrenë shqetësime për sigurinë kombëtare. Kështu ish-këshilltari i Shtëpisë së Bardhë Jared Kushner (dhëndri i Trump), dhe ish-Sekretari i Thesarit, Steven Mnuchin, kanë marrë miliarda dollarë nga Arabia Saudite për të krijuar kompanitë e tyre të menaxhimit të parave.

Këto marrëveshje duken ende si shitje e ndikimit, por për Trump ato dukeshin padyshim si mjete për përfitime të mëdha. Mos harroni se bizneset e Trump kanë qenë në vështirësi serioze. Kur Trump u largua nga Shtëpia e Bardhë, ato kishin rreth 1 miliard dollarë borxh, 900 milionë nga të cilat duhet të paguhen relativisht shpejt.

Ai garantoi personalisht shlyerjen e rreth 421 milionë dollarëve të atij borxhi. Dhe bizneset e tij – të përqendruara tek pasuritë e patundshme urbane dhe industria e argëtimit – u goditën nga rënia ekonomike që solli pandemia e Covid-19. Po ashtu Trump dhe kompania e tij, Organizata Trump, përballen me hetime për mashtrim në Nju Jork, që mund ta nxjerrin atë jashtë biznesit.

Ky është një presion i madh financiar, sidomos për dikë që

është tashmë i prirur të jetë një grumbullues parash. Kjo duhet të ngrëjë alarmin për çdo analist racional, që shqetësohet se Trump mund të jetë frymëzuar për të përdorur kompetencat dhe aksesin në të dhënat që isiguroi presidenca për të fituar para duke shpërndarë informacione të klasifikuara pasi u largua nga Shtëpia e Bardhë. Ndoshta nuk do të jetë kështu – dhe unë e shpresoj – por është e këshillueshme një vigjilencë ekstreme rreth këtij problemi të veçantë.

Arsyeja e tretë: Dëmtimi i reputacionit. Thuhet se Trump i mori me vete letrat që shkëmbeu me diktatorin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un. Ndoshta ky veprim u frymëzua nga vaniteti i tij, sepse Trump e ka cilësuar një korrespondencë të tillë si "letra dashurie". Por çfarë komunikimesh të tjera përmbajnë dokumentet që mbante Trump në shtëpinë e tij?

A ka ndonjë gjë me presidentin rus Vladimir Putin apo presidentin kinez Xi Jinping? Po në lidhje me dokumentet që kanë të bëjnë me bisedat telefonike të Trump me presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskiy, në kohën kur Trump po përpiqej të ushtronte presion ndaj tij për të gjetur fakte komprometuese mbi kundërshtarin e tij politik, Joe Biden.

Ishin këto komunikime që çuan në të parën nga dy procedurat e shkarkimit të Trump. Sërish, ndoshta nuk ka asgjë të tillë, dhe as në dokumentet që mban Trump me vete. Por nuk është e paarsyeshme të shqetësohemi se komunikimet e tij me liderët e huaj – dhe çdo gjë e

pandershme ose ndoshta e paligjshme që ka ndodhur në lidhje me to – mund të kenë pasur elementë të tillë që ai ndihet i detyruar t'i fshehtë.

Ritmi i furishëm me të cilin Trump ka mbjellë gënjeshtër pas kontrollit të FBI-së në Mar-a-Lago, sugjeron se ai ka diçka për të fshehur, dhe se është i shqetësuar për hetimin. Tek e fundit ai ka pohuar, pa asnjë fakt, se FBI fabrikoi prova në Mar-a-Lago.

Po ashtu tha se nuk ishte presidenti i parë që mernte me vete informacione të klasifikuara, dhe se ish-presidenti Barack Obama mban ende 33 milionë faqe dokumente "shumica prej tyre të klasifikuara". Arkivi Kombëtar që kontrollon të gjitha letrat e Obamës, e hodhi poshtë atë pretendim.

Ndërkaq, përmes një ndërmjetësi Trump e paralajmëroi Garland përpara konferencës së tij për shtyp javën e kaluar, se njerëzit ishin shumë të zemëruar nga kontrolli i FBI-së në Mar-a-Lago. Që nga ai moment, mbështetësit e armatosur të Trump kanë marshuar jashtë zyrave të FBI-së në Feniks.

Një person i armatosur që sulmoi një zyrë të FBI-së në Cincinnati të enjten e kaluar u qëllua për vdekje. Gjyqtari federal që miratoi urdhrin e kontrollit të FBI-së i është nënshtruar sulmeve dhe kërcënimeve antisemite në internet. Disa nga ato sulme ndodhën edhe në sinagogën e tij. Përfundimi me shpejtësi i këtij hetimi, përpara se dhuna të përshkallëzohet më tej, duhet të jetë një prioritet për organet e zbatimit të ligjit.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Daja pas fitores ndaj Shkupit: Ja çfarë pres në ndeshjen e dytë

SUHAREKË, 19 GUSHT - Ilir Daja konfirmohet një ekspert i ndeshjeve evropiane. Pasi siguroi grupet e Ligës së Evropës me Skënderbeun, është shumë pranë përsëritjes të të njëjtit sukses edhe me Ballkanin, pasi ka fituar ndeshjen e parë të "play-off"-it ndaj Shkupit. Pas ndeshjes në "Tose Proeski", trajneri nga Tirana foli për "DigitAlb", ku analizoi takimin dhe u shpreh se skuadra duhet të bëjë një tjetër 90 minutësh me pjekuri për ta siguruar kualifikimin.

Sa i kënaqur jeni për këtë fitore dhe sa e rëndësishme do të jetë për kualifikimin?

Daja: Ishte një ndeshje që do të vendosej nga episodet dhe ishim përgatitur për këtë ndaj më vjen mirë që sot morëm një rezultat pozitiv. Ne do të luajmë shanset tona për të shkuar në

fazën e grupeve, por nuk jemi favoritë as pas kësaj fitoreje. Ishim përgatitur që ta prisnim Shkupin, që e njeh më mirë këtë terren dhe ka cilësi për të bërë diferencën, ndaj lojtarët e interpretuan mirë ndeshjen.

Sa shanse ka Ballkani të shkojë në grupet e Ligës së Konferencës?

Daja: Çdo trajner ka dëshirë të kalojë në grupe. Unë kam luajtur edhe në "play-off" të Ligës së Evropës, por ne duhet të bëjmë maksimumin përballë një Shkupi që sot na vuri shumë në vështirësi. Nëse duam ta bëjmë atë hapin e madh, duhet që të ruajmë këtë mënyrë loje edhe në javën e ardhshme. Megjithatë më parë kemi kampionatin të dielën dhe pastaj do të mendojmë për ndeshjen e kthimit.

A mbetet loja në ajër e



kundërshtarit, një nga momentet që Ballkani e vuan jo pak?

Daja: Është një vërejtje me vend, pasi ne ndëshkohemi shpesh në goditjet standarde. Megjithatë duke mos pasur Rustem

Hoxhën dhe Sinanin, u penalizuam disi, pasi janë pikat tona të forta në lojën në ajër.

A zgjidhet ky problem në merkato?

Daja: Ne kemi bërë merkaton

më të mirë në Kosovë, pasi kemi mbajtur grupin fitues, por natyrshëm që na duhet të përforcohemi dhe lojtarin që do të zgjedhim, duhet ta gjejmë shtatlartë që të na ndihmojë edhe në lojën në ajër.

Ylli po shndrit



PRISHTINË, 19 GUSHT - Ylli Kastrati është një nga basketbollistët e rinj që shihet si e ardhmja e basketbollit të Kosovës. Kastrati përfaqësohet në Federatën e Basketbollit të Kosovës ka folur rreth sukseseve të vitit 2022. "Viti 2022 për mua ka qenë me shumë suksese, në të njëjtën kohë me shumë sfida. Fillimisht me ekipin Marigona Hill Prishtina jemi shpallur kampionë me generatat U-16 dhe U-14, ku edhe jam shpallur MVP. Po ashtu, këtë vit kam qenë pjesë e projektit FIBA YDF, ku gjatë kësaj kohe kemi marrë pjesë në turne që u mbajtën në disa vende si: Turqi, Rumani, Bullgari dhe Maqedoninë Veriore. Kjo njëherësh ishte përvojë e mirë në aspektin e zhvillimit tim si lojtar". Ylli ka folur edhe rreth përvojës së tij në kampin Jr. NBA të Evropës dhe Lindjes së Mesme:

"Këtë vit kam qenë i ftuar në kampin Jr. NBA të Evropës dhe Lindjes së Mesme e cila u mbajt në Itali. Gjatë këtij kampi kam mësuar shumë gjëra të reja nga trajnerët e nivelit më të lartë të cilët kanë udhëhequr ekipe të ndryshme në NBA. Pjesëmarrja ime në këtë kamp ka qenë një përvojë e paharrueshme". Kastrati, gjithashtu, ka qenë pjesë e Përfaqësueses U-16 e, sipas tij, përfaqësimi i Kosovës, sa është prioritet, është edhe kombëtares se Kosovës me generatën U-16, është një ndjenjë e veçantë, në të njëjtën kohë është edhe përgjegjësi e madhe për ta mbajtur fanellën e kombëtares së Kosovës, nënvizoi Kastrati, duke shtuar: "Po ashtu, do të doja t'i falënderoja trajnerët që deri tani bënë një punë të palodhshme me mua".

Duka: Liga e Kombeve, vendimtare për trajnerin Reja

TIRANË, 19 GUSHT - Armand Duka, presidenti i FSHF-së, ka dhënë një intervistë për RTSh-në. Ai ka folur edhe për trajnerin e kombëtares, Edy Reja. "Trajnerit i përfundon kontrata në nëntor, jo fiks pas përfundimit të ndeshjeve të shtatorit. Dy ndeshjet e fundit të Ligës së Kombeve ndaj Izraelit dhe Islandës janë shumë të rëndësishme. Ekzistojnë të gjitha mundësitë

që ne t'i fitojmë të dyja ndeshjet, por edhe mund të mos fitojmë në asnjërën. Pra, mund ta mbyllim edhe të parët grupin, por mund ta mbyllim edhe në vendin e fundit. Jemi në njëfarë mënyre me fat që nuk biem nga Liga B, por kemi edhe objektivin për të shkuar në Ligën A. Çdo gjë mund të ndodhë në këto dy ndeshje dhe rezultatet mund të sjellin ndryshime apo vendime të

reja", ka thënë Duka. "Trajneri dhe stafi i tij për mua kanë bërë një punë të mirë në ekipin shqiptar. Kemi rritje, kemi elementë të rinj në ekipin kombëtar, kemi një numër futbollistësh në dispozicion. Kështu që në përgjithësi kanë bërë një punë të mirë, por dy ndeshjet e shtatorit janë vendimtare për këtë kompeticion dhe për stafin", ka shtuar Duka.



Leclerc: Gati për ta vijuar betejën

MARANELLO, 19 GUSHT - Koha për pushime ka përfunduar dhe te Ferrari janë gati për t'u rikthyer në pistë për pjesën e dytë të sezonit. Kjo pjesë e parë ka qenë disi zhgënjyese për "kokëkuqen", që ka falur shumë

gara për shkak të gabimeve të skuadrës apo pilotëve të saj. Pavarësisht kësaj, Charles Leclerc shprehet se morali i skuadrës është i lartë: "Ka momente pozitive dhe negative dhe mendoj se diferenca për të

dalë nga momenti i vështirë vjen nga këto situata. Kemi parë me vëmendje çdo moment të këtij sezoni dhe kemi mësuar nga gabimet tona. Jemi të gjithë të bashkuar e gati për ta vijuar betejën. Ferrari ka treguar se

është një makinë e shpejtë këtë sezon, ndaj mund t'i mundim rivalët tanë. Gabimet janë pjesë e punës sonë. Mendoj se duhet t'i shohim gjërat pozitive që na motivojnë për të fituar sërish", ka shtuar Leclerc.



Kosova shënon ngritje në koeficientin e klubeve në UEFA

PRISHTINË, 19 GUSHT - Futbolli i Kosovës ka shënuar ngritje në koeficientin e klubeve në UEFA pas rezultateve pozitive të ekipeve në garat evropiane. Futbolli i Kosovës u përfaqësua nga katër klubeve në garat evropiane këtë sezon, për herë të parë në histori. Gjilani dhe Llapi u eliminuan në raundin e parë të kualifikueseve për Ligën e Konferencës, ndërsa Drita u eliminua në raundin e dytë. Kampioni i Kosovës, Ballkani u eliminua nga raundi i parë kualifikues në Ligën e Kampionëve, por po vazhdon me shumë sukses në kualifikueset e Ligës së Konferencës. Pas kalimit të dy raundeve, therandasi tani gjenden në fazën "play-off" dhe janë vetëm një ndeshje larg sigurimit të grupeve në garën e tretë evropiane për klube. Ballkani mposhti Shkupin me rezultat 2-1 në udhëtim në ndeshjen e parë dhe ndeshja kthyesë luhet pas një jave në Prishtinë, duke i dhënë mundësi



portokallezinjve t'i sigurojnë grupet.

Ky sukses i klubeve të Kosovës, në veçanti i Ballkanit, ka bërë që Kosova të ngrehet në koeficientet e UEFA-s. Kosova tani renditet në vendin e 33-të në Evropë, duke llogaritur koeficientet e klubeve

që marrin pjesë në garat ndërkombëtare, duke lënë mbrapa kampionatet rivale si Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Shqipëria në listën e përditësuar të UEFA-s renditet e 49-ta, Maqedonia e Veriut e 52-ta dhe Mali i Zi në pozitën e 54-t.

Marquez: Synoj të zhvilloj të paktën një garë këtë sezon

MADRID, 19 GUSHT - Piloti spanjoll i Hondas, Marc Marquez, i ka befasuar të gjithë kur ka deklaruar se dëshiron të zhvillojë të paktën një garë këtë sezon, pavarësisht operacionit në shpatull. Ai duhet të rikthehet në pistë vitin tjetër, por ikona e MotoGP ka të tjera plane. "Pas operacionit qëndrova pushim gjashtë javë dhe më pas hoqa mbrojtësen e krahut, duke nisur fizioterapinë. Javën e ardhshme do të bëj një kontroll dhe do të më thonë se çfarë do të bëj më tej. Në rast se rezultati do të jetë pozitiv, do të bëjmë një plan se kur mund të kthehem të garoj", ka thënë Marquez. "Mendoj se do të kem 70-80% të shanseve për të zhvilluar një garë këtë sezon. Kam shumë dëshirë të zbris në pistë që këtë sezon, por gjithçka do të varet nga kontrollat mjekësore. Para operacionit krahut im kishte limitet e tij, tani dua të shoh se deri ku mund të shkoj", ka shtuar piloti spanjoll.



Trajneri i PSG-së: Mbappe gjuan penalltinë e parë, Neymari të dytën

Trajneri i Paris Saint-Germain, Christophe Galtier, ka zhvilluar një takim me Kylian Mbappen dhe Neymarin pas polemikës që ndezi në fitoren 5-2 të ekipit

të tyre ndaj Montpellierit fundjavën e kaluar. PSG-ja mori dy penallti në atë ndeshje. Mbappe e mori përgjegjësinë për të parën dhe e humbi. Më

pas, Neymari mori të dytin dhe e shndërroi në gol, edhe pse Mbappe tentoi t'ia merrte topin shokut të skuadrës. Klubi donte të gjente një zgjidhje të shpejtë

për diçka që mund të bëhej problem dhe pas takimit të Galtierit me dy yjet, u vendos që Mbappe të ishte goditësi i parë i penalltive. Neymari do ta marrë

përgjegjësinë në rast se do të ketë një të dytë në të njëjtën lojë, pasi braziliani konsiderohet një nga gjuajtësit më të mirë të penalltive në Evropë.

SHKURT

Sejdiu nga 2 Korriku kalon te KEK-u

KF 2 Korriku ka njoftuar se me marrëveshje të dyanshme është ndërprerë bashkëpunimi me mesfushorin Qendrim Sejdiu. Sejdiu ishte pjesë e 2 Korrikut nga janari i vitit 2019, kurse me përvojën e tij ndihmoi skuadrën që në edicionin 2018/19 ta siguronte mbijetesën në Ligën e Parë, ndërsa në edicionet pasuese impresionoi me paraqitjet e tij si dhe supergolat e realizuara nga gjuajtjet e lira, gola që vërtet do të mbahen mend gjatë. 34-vjeçari tash ka vendosur për një aventurë të re në karrierën e tij, me ç'rast edhe ka kaluar te skuadra nga Obiliqi, KEK-u. 2 Korriku i ka uruar Sejdiut suksese në vazhdim të karrierës.

Adrion Pajaziti nënshkruan kontratë profesionale me Fulhamin

Adrion Pajaziti ka nënshkruar kontratë profesionale me klubin e njohur nga Premierë Liga, Fulham. Lajmin e ka dhënë klubi në rrjetet sociale. Marrëveshja e nënshkruar e mban mesfushorin në "Covern Cottage" deri në vitin 2026. Pajaziti luan për Përfaqësuesen e Kosovës për grupmoshat U-21. Në njoftimin e Fulhamit thuhet se lojtari u shqua për konsistencë në ndeshjet e sezonit të kaluar me grupmoshat e klubit.

Edhe Dortmundi refuzon Ronaldon

Borussia Dortmundi nuk është e interesuar për transferimin e Cristiano Ronaldos nga Manchester Unitedi ani pse portugezi ka pranuar që agjenti i tij të negociojë me klubin gjerman. Dortmundi është në kërkim të një zëvendësuesi për sulmuesin Sebastien Haller, por shuma që fiton Ronaldo në United prej 29 milionë eurosh në vit është e papërbalueshme për klubin e Dortmundit.

Ancelotti konfirmon kalimin e Casemiros në United

Duke folur në një konferencë për shtyp në prag të ndeshjes kundër Celta Vigos, trajneri Carlo Ancelotti ka konfirmuar mundësinë e transferimit të Casemiros te skuadra e Manchester Unitedit. "Kam folur me Casemiron gjatë kësaj jave. Më ka thënë se dëshiron të nisë një aventurë të re. Unë dhe klubi e kuptojmë, duhet ta kuptojmë dëshirën e tij dhe atë që ka dhënë këtu. Është një tratativë në zhvillim. Dëshira e tij është që të largohet. Nëse largohet, kemi fonde për ta zëvendësuar", ka thënë strategu i Real Madridit.

Emri më i përfolur për ta zëvendësuar është Bruno Guimaraes nga skuadra e Newcastle, por skuadra madrilene duhet të shpenzojë më shumë se 100 milionë euro për të.



Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Neni 4, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

KONKURS Për plotësimin e vendit të punës

Titulli: Auditor i Brendshëm - 1 (një) pozitë

Nr. i referencës: NPB/AB/01.3.1

I raporton: Menaxherit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm

Niveli i pagës: 4.1

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të pacaktuar (puna provuese deri në 3 muaj)

Vendi i punës: Rr. "Zija Shemsiu" nr.22, Ulpianë- Prishtinë (selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

Detyrat e përgjithshme:

- Në mënyrë efektive koordinon punën e auditimit me Menaxherin e Departamentit të Auditimit të Brendshëm dhe ofron mbështetje në ekip;
- Përfitim i njohurive të plota rreth departamenteve të audituara dhe kuptueshmëri të plotë të çështjeve, prioriteteve dhe rreziqet që i ballafaqojnë ato (pako për njohjen e punës);
- Ndihmon Menaxherin e Departamentit të Auditimit të Brendshëm në planifikim të auditimit, duke përfshirë programet dhe metodat auditimit;
- Kryerja e detyrave me përgjegjësi, të caktuara nga Menaxheri i Departamentit të Auditimit të Brendshëm;
- Raportimi i vazhdueshëm tek Menaxheri i Departamentit të Auditimit të Brendshëm lidhur me progresin e arritur në auditim;
- Përfundimi dhe indeksimi i letrave të punës për çdo fazë të auditimit dhe dorëzimi i tyre tek Menaxheri i Departamentit të Auditimit të Brendshëm;
- Ofron përkrahje profesionale duke kryer procedura analitike të të dhënave financiare dhe jo financiare;
- Shfrytëzimi i teknikave të sakta analitike dhe gjykimet për të arritur në konkluzione të qëndrueshme në bazë të dëshmive të mbledhura;
- Përgatitja e Letrave të Punës (memo përmbledhëse) lidhur me auditimin e komponentës apo fushës audituese e cila i është caktuar;
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Menaxheri i Departamentit të Auditimit të Brendshëm.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante;
- Certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave;
- Përvojë pune së paku 2 vite;
- 1 vite përvojë pune specifike në Auditim.

Kualifikimet e preferueshme:

- Preferohet kurset dhe trajnimet tjera profesionale gjatë karrierës

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrë të Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: www.npbanesore.com/shpalljet/mundesi-punesimi/. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: Rr. Zija Shemsiu, nr. 22, Prishtinë, ose të aplikojnë përmes emailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com apo përmes postës. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten;

- Aplikacioni i NPB-së;
- CV/Resume;
- Dëshmitë për kualifikimin universitar;
- Certifikatën Auditor i Brendshëm i Certifikuar;
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj); - Kopjen e letërnjoftimit;

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen. Kandidati/ia i/e përzgjedhur obligohet të sjellë certifikatën mjekësore para nënshkrimit të kontratës.

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIONIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Shpallja është e hapur që nga data 19.08.2022 deri më 02.09.2022

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 553 311.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Blendi Duraku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U. Zekrija Rexha" nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Blendi Duraku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha".
- ▶ Valbon Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U "Haxhi Hoti" Rogovë nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ ELSA VESELI, shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 11 te SHML "DR XHELADIN DEDA".
- ▶ ANESA SUHOGERLLA, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës.
- ▶ ORHAN HYSENI B.I, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 70376080.
- ▶ ANIS SHPK, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810140575.
- ▶ MUSTAF MUSTAFA, shpall te pavlefshëm diplomën dhe dëftesat e SHML "DR. XHELADIN DEDA".
- ▶ EGZON OSMANI, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës se mesme "DR.XHELADIN DEDA" dhe certifikatën e maturës.
- ▶ ELVIRA HAJRA, shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës se mesme se klasës se 10, Shkolla "DR. XHELADIN DEDA".
- ▶ VALDRIN BERISHA, shpall te pavlefshme testin e maturës se shkollës se mesme "HASAN PRISHTINA". ARIANIT SADIKU, shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "AZIZ SYLEJMANI".
- ▶ VIOLA IGRISHTA, shpall te pavlefshme certifikatat e klasës se 1 deri ne te 9, te Shkollës fillore "MIGJENI". DARDAN BAJRAMI, shpall te pavlefshme dy dëftesat e vitit te pare dhe te dyte te shkollës së mesme.
- ▶ JANUZ ABAZI, shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore nga klasa e 1 deri 8 shkolla "ELENA GJIKA" ish-shkolla "RADE MILECOVIC".
- ▶ ZYHRIE BEKTESHI, shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore nga klasa e 1 deri 8,shkolla "XHEVAT ISUFI" ish-shkolla "RIFAT VIDISHIQI".
- ▶ ELDA VOCA, shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës se mesme te klasës se 10 dhe 11, shkolla "DR .XHELADIN DEDA".
- ▶ SHERIF MUSAJ B.I, shpall te pa vlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 811315151.
- ▶ ALBAN SYLEJMANI, shpall te pa vlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 71193896.
- ▶ ERDUAN PEÇI, shpall te pavlefshme diplomën e SHML "DR. XHELADIN DEDA".
- ▶ RAMADAN BEQIRI, shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "HIVZI SYLEJMANI" KQIQ I MADH. BELGIN EMERLLAHU, shpall te pavlefshme dëftesën e vitit te 3 dhe te 4 dhe diplomën e SHML "DR. XHELADIN DEDA".
- ▶ NEXHDET PARDUZI, shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore nga klasa e 1 deri te 8 shkolla 'MIGJENI' 'ish shkolla 25MAJI.
- ▶ DPZ "XHAFI.COM" shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 70888742.
- ▶ AURORA MEDIA shpall te pa vlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 811879470.
- ▶ Kaltrina Sylja shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme mjekësie "Dr. Xheladin Deda"
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

